



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01– Nr. 400-28468/15
Kaçanik, 29.09.2015.

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61. të Ligjit nr.03/L-048. – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, si dhe nenit 34.5 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me datë: 29.09.2015, mori këtë:

V E N D I M PËR BUXHETIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN FISKAL 2016 DHE VLERËSIMET PËR VITET 2017 – 2018

1. Me këtë vendim, miratohet buxheti i komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2016 dhe vlerësimet për vitet, 2017-2018.
 2. Buxheti total i Komunës së Kaçanikut për vitin buxhetor 2016 është në shumë prej **6,631,386 €**, ndërkaq për vitin 2017 vlerësimet e projektuara janë në masë monetare prej 6,691,700 € dhe për vitin 2018 në shumë prej 6,761,056 €.
 3. Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin buxhetor 2016., sipas pikës 2. të këtij vendimi, mjetet nga Grantet qeveritare janë në shumë prej **5,921,714 €**, që shënojnë pjesmarrje me 89,3% dhe të hyrat vetjake komunale, në shumë prej **709,672 €**, me një pjesmarrje prej 10,7% në strukturën e përgjithshme të buxhetit.
 4. Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin buxhetor 2016, parashikohen që të jenë të ndarë për Shpenzime Operative, shuma prej **5,578,127 €** dhe për Investime Kapitale, shuma prej **1,053,259 €**.
 5. Shpenzimet buxhetore për vitin 2016, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, parashikohet të kenë këto ndarje e të cilat janë në përputhje të plotë me Qarkoren Buxhetore 2016/02 të Ministrisë së Financave:

1. Shpenzimet për Paga dhe Mëditje	4,730,156 €
2. Shpenzimet e Mallrave dhe Shërbimeve	504,281 €
3. Shpenzimet e Shërbimeve Komunale	139,000 €
4. Subvencionet dhe Transferet	204,690 €
5. Shpenzimet në Investime Kapitale	1,053,259 €
 6. Për zbatimin e këtij vendimi për buxhetin e komunës, obligohet Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit.
 7. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.
- Vendimi u dërgohet:** Kryetarit të Komunës, Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Zhvillim- përmes kësaj drejtorie njoftohen organet tjera relevante, dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Xhela Gashi